



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM

Rasti: Bashkimi me përthithje i shoqërisë GEGA OIL SHA nga shoqëria GENKLAUDIS SHA.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 62/1 prot., i AK, datë 08.02.2023, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me transaksionin e bashkimit me përthithje të shoqërisë GEGA OIL SHA nga shoqëria GENKLAUDIS SHA.

Referuar dokumentit “Marrëveshja e Bashkimit me Përthithje midis shoqërive GENKLAUDIS SHA dhe GEGA OIL SHA”, palët në marrëveshje janë:

Shoqëria blerëse: GENKLAUDIS SHA është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Tregtim me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve, përfshirë ato bio, si dhe lëndëve djegëse, duke përfshirë tregtimin me shumicë të naftës bruto e nënprodukteve të saj, tregtim me shumicë i gazit të lëngshëm të naftës etj.

Pala shitëse: z. K. G. dhe z. G. G. janë persona fizikë, shtetas shqiptar.

Shoqëria target: GEGA OIL SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Tregtim me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve, përfshirë ato bio, si dhe lëndëve djegëse, duke përfshirë tregtimin me shumicë të naftës bruto e nënprodukteve të saj, tregtim me shumicë i gazit të lëngshëm të naftës etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.